

# **Peticion drejtuar Parlamentit Gjerman (Bundestag)**

Ne të nënshkruarit kerkojmë:

- 1. Të pranohen dokumentet e lëshuara - veçanërisht dokumentet e udhëtimit - nga Administrata e Misionit të OKB-së (UNMIK) për qytetarët e Kosovës që jetojnë në Republikën Federale të Gjermanisë dhe të ndërpritet menjëherë praktika e detyrimit të qytetarëve nga Kosova për t'u pajisur me pasaportat e Unionit Serbi-Mali i Zi.**
- 2. Të lejohet hapja e nje Përfaqësie zyrtare të Kosovës në Republikën Federale të Gjermanisë.**
- 3. Qytetarët e Kosovës që paraqesin kërkesën për marrjen e shtetësisë gjermane të lirohen nga detyrimi për paraqitjen e dëshmisë për lirin nga shtetësia e Unionit Serbi-Mali i Zi.**
- 4. Të shkurtrohet procedura e dhënies së vizave ne Zyrën Gjermane në Prishtinë.**

## **Arsyetim**

### **1. Lidhur me kërkesën e parë**

- Duke pasur parasysh faktin se Kosova administrohet nga Misioni i OKB-së (UNMIK),
- duke pasur parasysh faktin se jo Unioni Serbi-Mali i Zi, por UNMIK-u është autoriteti i vetëm për t'i pajisur me dokumentet e udhëtimit dhe të identitetit qytetarët e Kosovës kudo që jetojnë,
- duke pasur parasysh faktin se për qytetarët nga Kosova, Unioni Serbi-Mali i Zi është një shtet i huaj,
- duke pasur parasysh faktin se Unioni Serbi-Mali i Zi nuk ushtron pushtetin shtetëror në Kosovë;

### **2. Lidhur me kërkesën e dytë**

- Duke pasur parasysh faktin se për qytetarët e Kosovës që jetojnë në Republikën Federale të Gjermanisë, përfaqësitë diplomatike të Unionit Serbi-Mali i Zi janë përfaqësi të një shteti të huaj,
- duke pasur parasysh faktin se jo përfaqësitë zyrtare të Unionit Serbi-Mali i Zi, por vetëm Administrata e Misionit të OKB-së (UNMIK) dhe përfaqësitë zyrtare të Kosovës kanë mundësi dhe të drejtë t'i mbrojnë dhe realizojnë interesat e qytetarëve nga Kosova që jetojnë në Gjermani;

### **3. Lidhur me kërkesën e tretë**

- Duke pasur parasysh vështirësitë e jashtëzakonshme me të cilat ndeshen qytetarët e Kosovës me banim në Gjermani gjatë procedurës për lirin nga shtetësia e Unionit Serbi-Mali i Zi (sjelljet jokorrekte të autoriteteve shtetërore, kërkesat për pagim të shumave të larta të hollave etj.),
- duke pasur parasysh faktin se ky Union nuk ka legjitimitet për të lëshuar një dokument të tillë,
- duke u nisur nga fakti se strukturat e tanishme të pushtetit në Unionin Serbi-Mali i Zi janë të njëjta me ato struktura të pushtetit të Millosheviçit që shkaktuan tragjedi njerëzore jo vetëm në Kosovë, por edhe në tërë territorin e ish-Jugosllavisë;

### **4. Lidhur me kërkesën e katërt**

- Duke pasur parasysh vështirësitë e familjarëve tanë – dihet roli i pazëvendësueshëm i familjes në rastet e gëzimit dhe të hidhërimit - gjatë procedurës për marrjen e vizave në Zyrën Gjermane në Prishtinë (kohëzgjatja deri në tetë muaj apo edhe më gjatë për dhënien e një vize),
- duke pasur parasysh faktin se për shkak të kohëzgjatjes së jashtëzakonshme të procedurës për dhënien e vizave, janë krijuar rrjete joligjore që kërkojnë mito për shkurtimin e kësaj procedure;

- **Të bindur se vetëm Administrata e Misionit të OKB-së (UNMIK) dhe institucionet e Kosovës mund t'i mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës kudo që janë,**
- **duke konsideruar dhe besuar se kërkesat tona janë të ligjshme dhe të arsyeshme, shfrytëzojmë të drejtën tonë kushtetuese për peticion sipas nenit 17 të Kushtetutës së Republikës Federale të Gjermanisë me bindjen e plotë se kërkesat tona do të realizohen, me çka do të na kursenit nga hapat e tjerë të lejuar me ligj që mund të pasojnë.**

Me nderime

Nënshkruesit e Peticionit